



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 223, Datë 09.11.2021

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 198, DATË 03.09.2018 MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SH.A., (FTL SH.A.) NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.139/3 prot., datë 02.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 – vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018.
- Kushti i pikës 2 i vendimit të bordit të ERE-s nr.198, datë 03.09. 2018, kërkon që: 2. Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a (FTL sh.a), të paraqesi në ERE listën e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL sh.a), nga struktura përkatëse.
- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, konkretisht në nenin 9, pika 2, gërma “e” kërkohet: “Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse...”
- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. me shkresën nr. 2852/1 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 972/1 prot., datë 18.10.2021, ka bërë me dije ndër të tjera se në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. dhe në funksion të

veprimtarisë së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. është kryer transferimi i strukturës përkatëse nga punëdhënësi “OSHEE” sh.a. te punëdhënësi “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. Në vijim të këtij procesi shoqëria ka dokumentuar në ERE edhe organigramën e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a.

- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.
- Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore tëndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.